



FEDERATA E PINGPONGUT E KOSOVËS
KOSOVO TABLE TENNIS ASSOCIATION

Shtëpia e Sportit, rr. Agim Ramadani nr. 253, kati I, zyra nr. 7, Prishtinë
Tel: +383-44-170-586 / Email: info@fppk.com / ueb: www.fppk.com

KODI DISIPLINOR

PRISHTINË 2024

Në përputhje me nenin 15 paragrafi 2.1 të Statutit të Federatës së Pingpongut të Kosovës, Federata e Pingpongut e Kosovës, në mbledhjen e datës: 14/12/2024 miratoi këtë::

KOD DISIPLINOR

TË FEDERATËS SË PINGPONGUT TË KOSOVËS

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

- 1.1. Kodi disiplinor i Federatës së Pingpongut të Kosovës parasheh masat dhe përcakton procedurën e dënimit të sportistëve, udhëheqësve teknik, udhëheqësve tjerë dhe gjithë pjesëmarrësve në gara dhe aktivitete tjera që bëjnë shkelje të Rregullores mbi organizimin e garave ose shkelin Rregullat e lojës, Statutin e FPPK, Ligjin e sportit si aktet tjera normative të FPPK-së.

Neni 2

- 2.1 Ky Kod ka të bëjë dhe zbatohet:
- për të gjithë garuesit, pjesëmarrësit në gara,
 - për të gjitha ekipet, anëtarët dhe udhëheqësit e tyre gjatë gjithë kohës së zgjatjes së garave,
 - për të gjithë punëtorët sportiv të cilët punojnë në organizimin dhe realizimin e programeve sportive, gjyqtarët, personat zyrtarë dhe pjesëmarrësit tjerë në të gjitha nivelet.

Neni 3

- 3.1. Mosnjohja e Statutit, Propozicioneve të garave, Rregullores mbi organizimin e garave dhe Kodit disiplinor të FPPK-së, askënd nuk e liron nga përgjegjësia për mosrespektimin e dispozitave të tyre.

Neni 4

- 4.1 Nëse personat e cekur në nenin 3 të këtij Kodi disiplinor nxisin apo ndihmojnë në kryerjen e kundërvajtjeve, do të dënohen sikurse vetë ta kishin bërë kundërvajtjen (shkeljen).

Neni 5

- 5.1. Para shqiptimit të dënimit për kundërvajtje merret në konsiderim, veçanërisht:
- pesha e shkeljes dhe pasojat e saj ;
 - shkalla e përgjegjësisë ;
 - kushtet nën të cilat është shkaktuar shkelja ;
 - puna dhe sjelljet e mëparshme të kundërvajtësit ;
 - si dhe rrethanat tjera të cilat kishin mund me ndikuar në shqiptimin e dënimit.

Neni 6

- 6.1 Nëse ndonjë kundërvajtje nuk është paraparë me këtë Kod disiplinor, do të shqiptohet dënimi sipas dispozitave të parapara për kundërvajtje të ngjashme.

Neni 7

- 7.1. Kundërvajtësi nuk mund të dënohet pa e dëgjuar atë, apo nëse nuk sjellë deklaratë me shkrim në afat prej 8 ditësh nga dita e kryerjes së kundërvajtjes.
- 7.2 Nëse kryesi i kundërvajtjes refuzon të vijë në dëgjim për tu marrë në pyetje apo nuk donë të japi deklaratë me shkrim në afatin e dhënë atëherë dënimi i shqiptohet në bazë dokumentacionit (provave) që janë në disponim.

Neni 8

- 8.1 Çdo Vendim mbi dënim duhet të evidentohet në Regjistrin e dënimeve i cili mbahet në FPPK .

II. LLOJET E DËNIMEVE

Neni 9

- 9.1 Për sportistë :
- Vërejtje,
 - Ndalimi i vazhdimit në gara,
 - Ndalimi i pjesëmarrjes në gara në afat të caktuar kohor.
- 9.2 Për ekipe :
- Vërejtje,
 - Ndalimi i vazhdimit në gara,
 - Ndalimi i pjesëmarrjes në gara në afat të caktuar kohor.
- 9.3 Për zyrtarë dhe udhëheqës në gara :
- Vërejtje,
 - Qortim,
 - Largim nga garat,
 - Ndalimi i ushtrimit të funksionit në kohë të caktuar,
 - Ndalesë e përhershme e ushtrimit të funksionit.
- 9.4 Për Udhëheqës të klubeve, shoqatave dhe udhëheqës të tjerë të asociacioneve brenda FPPK-së :
- Vërejtje,
 - Qortim,
 - Ndalimi i ushtrimit të funksionit në kohë të caktuar,
 - Ndalesë e përhershme e ushtrimit të funksionit.

9.5 Për gjyqtarë :

- Vërejtje,
- Qortim,
- Largim nga garat,
- Ndalimi i ushtrimit të funksionit në kohë të caktuar,
- Ndalesë e përhershme e ushtrimit të funksionit.

9.6. Për të gjitha masat dhe dënimet e shqiptuara njoftohet FPPK-ja dhe palët e përfshira.

Neni 10

- 10.1 Nëse garuesi përdorë mjete të ndaluara në sezonin garues i shqiptohet dënimi NDALIM i pjesëmarrjes në periudhën më së paku 15 muaj.
- 10.2 Tek kundërvajtja e përsëritur shqiptohet dënimi NDALESË E PËRHERSHME e pjesëmarrjes në gara.

III. LLOJET E KUNDËRVAJTJEVE DHE DËNIMET

Neni 11

A. Sjelljet jo sportive :

- 11.1 Këto kundërvajtje mund të shkaktohen nga: sportisti, ekipi, Udhëheqësit dhe Personat zyrtarë në gara.
- 11.2 Si sjellje jo sportive mund të trajtohen këto veprime :
- Sjellja e pahijshme,
 - Gjest i pahijshëm,
 - Sharje dhe thënie fyese verbale ,
 - Kundërshtimet dhe grindjet,
 - Mosrespektimi i Vendimeve të Gjyqtareve,
 - Mosrespektimi i Rregullave të lojës,
 - Provokimi i publikes, mysafirëve të pranishëm, Udhëheqësve dhe personave zyrtarë.
 - Çdo sjellje e cila e prish prestigjin e garave.
- 11.3 Për këto kundërvajtje shqiptohet njëri nga dënimet e përcaktuara në kaptinën e II (e dytë) të këtij Kodi disiplinor.

Neni 12

B. Sulmi fizik

- 12.1 Sulmi fizik në sportistin, gjyqtarin, shikuesit, mysafirët apo Udhëheqës dhe persona zyrtarë- vendas apo të ekipit kundërshtar, para, gjatë apo pas garave, trajtohet si kundërvajtje e rëndë për të cilën shqiptohet njëri nga dënimet e parapara në kaptinën e II (e dytë) të këtij Kodi disiplinor.

Neni 13

C. Mosardhja, mos përgjigjja në gara apo lëshimi i garave pa arsye

- 13.1 Mosardhja, mos përgjigjja në gara apo lëshimi i garave pa arsye është kundërvajtje disiplinore për shkak të cilës sportistit, ekipit, klubit apo Shoqatës i shqiptohet dënimi si në vijim :
- Vërejtje,
 - Ndalimi i vazhdimit në gara,
 - Ndalimi i pjesëmarrjes në gara në afat të caktuar kohor.

Neni 14

D. Parregullsitë para fillimit të garave

- 14.1 Parregullsitë para fillimit të garave janë :
- Libreza e sportistit e pavërtetuar,
 - Tejkalimi i afatit për kontrollim mjekësor,
 - Radhitja e kategorisë së moshave gabimisht,
 - Shfrytëzimi i pajisjeve sportive të parregullta,
 - Marrja pjesë në gara me masën e shqiptuar ndalesë.
 - Shkuarja e klubeve në gara jashtë vendit pa pëlqimin e FPPK-së.
 - Pjesëmarrja e ekipeve të jashtme në gara të cilat i organizojnë klubet pa pëlqimin e FPPK-së.
 - Pjesëmarrja e anëtarëve të reprezentacionit në çfarëdo gara apo turne pa pëlqimin e elektorit të reprezentacionit dhe FPPK-së.
- 14.2 Për kundërvajtjet e lartcekura, ekipit apo sportistit (varet nga pjesëmarrja) i shqiptohet dënimi:
- Vërejtje,
 - Ndalimi i vazhdimit në gara,
 - Ndalimi i pjesëmarrjes në gara në afat të caktuar kohor.
- 14.3 Rezultatet e arritura fshihen (nuk evidentohen) kurse shpërblimet eventuale iu merren dhe dorëzohen në FPPK.

14.4 Po ashtu për kundërvajtjet e lartcekura në pikat e këtij neni edhe për funksionarët dhe personat zyrtar të cilët kanë qenë në dijeni (nuk kanë ndërmarrë asgjë) apo kanë qenë vetë pjesëmarrës iu shqiptohet dënimi :

- Vërejtje,
- Ndalim i vazhdimit të garave,
- Ndalimi i pjesëmarrjes në gara në kohë të caktuar,
- Ndalesë i ushtrimit të funksionit.

Neni 15

DH. Tërheqja nga garat

15.1 Tërheqja nga garat është kundërvajtje e lehtë për çka shqiptohet dënimi :

- Vërejtje,
- Ndalim i vazhdimit të garave,
- Ndalimi i pjesëmarrjes në gara në kohë të caktuar.

15.2 Pikët dhe shpërblimet e fituara iu merren, kurse rezultatet e arritura iu fshihen.

Neni 16

Nëse garat zgjasin më tepër ditë, e garuesi dënohet gjatë ditëve të para të garave ai nuk mund të jetë pjesëmarrës në vazhdimin e garave në ditët që vijojnë.

Neni 17

E. Ofendimi, sulmi verbal, shpifjet

17.1 Ofendimi, sulmi verbal, shpifjet si dhe thëniet verbale të ngjashme të drejtuara sportistëve (të vet apo palës kundërshtare), personave zyrtarë, gjyqtarëve, funksionarëve, organizatorëve dhe publikes konsiderohen kundërvajtje për të cilat shqiptohet dënimi :

- Vërejtje,
- Ndalim i vazhdimit të garave,
- Ndalimi i pjesëmarrjes në gara në kohë të caktuar.

17.2 Në rast të ndalimit të vazhdimit të garave, ekipit apo ekipeve pikët dhe shpërblimet iu merren, kurse në garat individuale rezultatet e sportistit i cili ka bërë kundërvajtje fshihen.

Neni 18

18.1 Nëse referët (gjyqtarët) dhe personat zyrtarë bëjnë kundërvajtje apo sillen në mënyrë jo sportive si vijon :

- Mosardhja në garë,
- Tërheqja nga garat pa arsye apo pa paralajmërim,

- Konflikti fizik me të pranishmit (sportistët, mysafirët, funksionarët dhe organizatorët),
- Konflikti verbal me të pranishmit (sportistët, mysafirët, funksionarët e organizatorët),
- Sjelljes jo sportive.

18.2 Për rastet e lartcekura iu shqiptohet masa e ndalimit të ushtrimit të detyrës në kohë të caktuar: së paku 6 muaj e deri tek ndalesa e përhershme.

IV. PROCEDURA DISIPLINORE

Neni 19

1. Fletëparaqitja :

19.1 Procedura disiplinore mund të fillohet në bazë të:

- Raportit të gjyqtarit,
- Raportit nga gara,
- Fletëparaqitjes nga personi i cili e ka vërejt kundërvajtjen,
- Detyrës zyrtare të Komisionit ose përgjegjësit të aktivitetit i cili në çfarëdo mënyre vjen në dijeni që kundërvajtja është kryer.

19.2 Fletëparaqitja disiplinore i dërgohet Komisionit disiplinor të FPPK-së.

Neni 20

20.1 Fletëparaqitja disiplinore paraqitet kur ekzistojnë bazat e dyshimit se është bërë kundërvajtja.

20.2 Fletëparaqitja duhet të përmbaj:

- emrin dhe mbiemrin e personit-ave me shënimet elementare të tij-tyre ,
- kohën, vendin dhe mënyrën e kryerjes së kundërvajtjes,
- të dhënat për dëmin eventual,
- provat,
- shkaqet në të cilat bazohen bazat e dyshimit se është bërë kundërvajtja,
- emri, mbiemri, pozita dhe nënshkrimi i parashtruesit.

Neni 21

21.1 Kryetari i komisionit disiplinor me vendim e hedh poshtë fletëparaqitjen disiplinore në qoftë se:

- është e rrejshme
- ka të bëjë me veprimet a mosveprimet të cilat nuk janë paraparë si kundërvajtje,
- është paraqitur parashkrimi (është vjetërsuar)
- për kundërvajtje të njëjtë me vendim definitiv është përfunduar procedura disiplinore.

- 21.2 Kundër vendimit nga paragrafi paraprak, parashtruesi i fletëparaqitjes ka të drejtë kundërshtimi organit disiplinor të shkallës së dytë, Bordit të Apelit, në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të vendimit.

Neni 22

- 22.1 Kryetari i Komisionit disiplinor në bashkëpunim me anëtarët tjerë vlerëson se a ka nevojë që të zhvillohet procedura paraprake.
- 22.2 Personi që udhëheq procedurën paraprake është i autorizuar që :
- të marr deklaratë nga kundërvajtësi i fajësuar,
 - të siguroj prova (dokumente të nevojshme),
 - të dëgjoj dëshmitarët,
 - të bëjë shikimin në vend,
 - të organizojë ekspertizën dhe të ndërmarr veprime tjera me interes për përgatitje të shqyrtimit.

2. Komisioni disiplinor

Neni 23

- 23.1 Komisioni disiplinor udhëheq procedurën disiplinore, konstaton përgjegjësinë disiplinore dhe shqipton masa disiplinore në shkallë të parë, të gjithë kundërvajtësve pavarësisht nga autorizimet që i kanë.
- 23.3 Komisioni disiplinor përbëhet prej 3 anëtarëve, të cilët i zgjedhë Kuvendi i FPPK.
- 23.4 Në rast mungese a pengese tjetër të kryetarit apo ndonjë anëtari të Komisionit disiplinor, Kryetari i Federatës me Vendim do ta caktoj për rastin konkret disiplinor (ad hoc) një delegat tjetër të Kuvendit.

3. Procedura e punës e Komisionit disiplinor

Neni 24

- 24.1 Komisioni disiplinor është i obliguar që Fletëparaqitjen, ta shqyrtoi dhe merr në procedurë në afat prej 15 dite, nga dita kur e ka pranuar.

Neni 25

- 25.1 Kryetari i Komisionit e cakton seancën e Komisionit disiplinor.
- 25.2 Ftesa për seancë ju dërgohet me shkrim:
- përfaqësuesit të fletëparaqitjes;
 - kundërvajtësit kundër të cilit zhvillohet procedura disiplinore;
 - përfaqësuesit të personit nëse ai ka angazhuar të tillë ;
 - dëshmitarit dhe ekspertit, kur është e nevojshme.
- 25.3 Nëse kundërvajtësi nuk gjendet në adresën e tij, apo refuzon ti pranojë shkresat, dorëzimi bëhet në atë mënyrë, me publikimin e saj në tabelën e shpalljeve të FPPK-së.

Neni 26

- 26.1 Thirrja kundërvajtësit duhet të dërgohet së paku 3 ditë para mbajtjes së seancës kryesore, me qëllim që kundërvajtësi të përgatit mbrojtjen.
- 26.2 Dërgimi i ftesës, vendimit dhe shkresave tjera kundërvajtësit i bëhet me emalin elektronik përmes administratës së FPPK-së ndërsa në rast të shtyrjes së seancës, me njoftim në procesverbal.

Neni 27

- 27.1 Procedura para Komisionit disiplinor është publike.
- 27.2 Kundërvajtësi patjetër duhet të dëgjohet para Komisionit disiplinor dhe duhet t'i mundësohet mbrojtja.

Neni 28

- 28.1 Seanca para Komisionit disiplinor fillohet me leximin e Fletëparaqitjes.
- 28.2 Pas leximit të Fletëparaqitjes, ftohet kundërvajtësi kundër të cilit udhëhiqet procedura që të deklarohet lidhur me thëniet në fletëparaqitje dhe që të paraqesë mbrojtjen e vet.
- 28.3 Pas deklaratës së kundërvajtësit fillohet me nxjerrjen e provave lidhur me vërtetimin e fakteve.

Neni 29

- 29.1 Para fillimit të seancës, Udhëheqësi i procedurës, vërteton se a janë të pranishëm të gjithë personat e ftuar.
- 29.2 Nëse nuk ka ardhur kundërvajtësi kundër të cilit udhëhiqet procedura, Komisioni vendos që seanca të mbahet në mungesë të tij, apo do të shtyhet.
- 29.3 Nëse kundërvajtësi është ftuar në rregull, ndërsa mungesën nuk e ka arsyetuar, seanca mund të mbahet në mungesë të tij.
- 29.4 Me rastin e shtyrjes së seancës caktohet, mundësisht dita dhe ora e vazhdimit të saj.

Neni 30

- 30.1 Në seancë mbahet procesverbali, procesverbalin e nënshkruan Komisioni .

Neni 31

- 31.1 Komisioni vendos se cilat prova do të nxjerr dhe sipas cilës renditje.

Neni 32

- 32.1 Pas përfundimit të procedurës së nxjerrjes së provave, Komisioni ia jep fjalën, parashtruesit të fletëparaqitjes, mbrojtësit (nëse ka), e pastaj edhe kundërvajtësit kundër të cilit udhëhiqet procedura, që të japin fjalën përfundimtare.

32.2 Pas kësaj Komisioni tërhiqet në këshillim dhe votim (marrje të vendimit)

Neni 33

33.1 Komisioni mund të nxjerr njërin nga këto Vendime :

- që procedura të pezullohet për një periudhë të arsyeshme;
- që kundërvajtësi të lirohet nga përgjegjësia ;
- që t'i shqiptohet masa e caktuar disiplinore.

Neni 34

34.1 Vendimi i Komisionit përmban :

1. Hyrjen, në të cilën shënohet: Emërtimi i organit i cili e ka nxjerr Vendimin, përbërja e organit, lloji i shkeljes, data e mbajtjes së seancës;
2. Dispozitivin, në të cilin shënohet, ndaj kujt dhe çfarë mase disiplinore është shqiptuar; gjegjësisht se a është liruar kundërvajtësi nga përgjegjësia;
3. Arsyetimi, në të cilin ceket faktet vendimtare në të cilat Komisioni është bazuar që kundërvajtësin ta liroi nga përgjegjësia apo ta shpalli përgjegjës;
4. Këshillën juridike, në të cilën shënohet emërtimi i organit të shkallës së dytë i cili vendos për Ankesën si dhe afati i kundërshtimit.

Neni 35

35.1 Kryetari apo anëtarët e Komisionit Disiplinor nuk mund të hyn në përbërje të Komisionit:

- nëse është palë e dëmtuar me shkeljen e detyrave të punës ;
- nëse me kundërvajtësin, mbrojtësin e tij janë në marrëdhënie të afërt familjare .

4. Organi disiplinor i shkallës së dytë, Bordi i Apelit

Neni 36

36.1 Kundër Vendimit të Komisionit disiplinor, mund të parashtrohet Ankesë Bordit të Apelit të FPPK (si organ i shkallës së dytë), dhe atë përmes Komisionit disiplinor në afat prej 30 dite.

36.2 Kundër Vendimit të Bordit të Apelit të FPPK-së, kundërvajtësi mund të shfrytëzoj mjetet juridike të parapara në nenin 39 të Statutit të FPPK-së.

Neni 37

37.1 Bordi i Apelit mundet :

- Pranoj ankesën dhe ndryshoj vendimin e Komisionit disiplinor;
- Refuzoj ankesën dhe konfirmoj vendimin e Komisionit disiplinor;
- Kthej ankesën për rishqyrtim te Komisioni disiplinor;

- Refuzoj ankesën në rastet kur ankesa është parashtruar jashtë afatit ligjor apo është e pabazuar e parashtruar në kundërshtim me Statutin, këtë Rregullore dhe aktet normative përkatëse në fuqi.

Vendimet e Bordit të Apelit janë përfundimtare dhe detyruese për të gjitha palët

Neni 38

- 38.1 Bordi i Apelit është i obliguar që të nxjerr Vendim sipas Ankesës në afat prej 30 dite, nga dita e pranimi të saj.

Neni 39

- 39.1 Nëse Bordi i Apelit nuk nxjerr Vendim sipas Ankesës në afat prej 30 ditësh, kundërvajtësi ka të drejtë të përdor mjetet tjera juridike të parapara në nenin 39 të statutit të FPPK-së.

5. Parashkrimi i procedurës disiplinore

Neni 40

- 40.1 Fillimi dhe zhvillimi i procedurës disiplinore parashkruhet me kalimin e periudhës 1 vjeçare nga dita e njohurisë për kryerjen e kundërvajtjes dhe kryerësin e saj, por nuk mund të fillohet pas kalimit të afatit 2 vjeçar nga dita e kryerjes së shkeljes.

6. Evidenca e masave disiplinore të shqiptuara

Neni 41

- 41.1 Në FPPK – mbahet Evidenca e masave disiplinore të shqiptuara në bazë të vendimeve definitive mbi shqiptimin e tyre.
- 42.2 Evidenca e masave të shqiptuara përmban:
- Emrin dhe mbiemrin e personit (fizik-juridik) të cilit i është shqiptuar masa disiplinore,
 - Funkzioni që e kryen,
 - Numri dhe data e vendimit definitiv mbi masën e shqiptuar disiplinore,
 - Për cilën kundërvajtje i është shqiptuar masa ,
 - Cila masë i është shqiptuar,
 - Datën e plotfuqishmërisë së vendimit,
 - A është ushtruar ankesë në vendimin e komisionit disiplinor dhe çfarë vendimi është marrë sipas ankesës,
 - A është zhvilluar kontest pranë gjykatës dhe çfarë vendimi ka marrë gjykata.
- 42.3 Evidencën mbi shqiptimin e masave disiplinore e udhëheq punonjësi i cili kryen punët profesionale për nevoja të komisionit disiplinor.

7. Përsëritja e procedurës

Neni 42

- 42.1 Procedura disiplinore e përfunduar definitivisht mund të përsëritet vetëm në këto raste :
1. Nëse kundërvajtësit me veprim të kundërligjshëm, e posaçërisht me lëshimin e dërgimit të ftesës, nuk i është dhënë mundësia që të marrë pjesë në seance;
 2. Nëse Vendimi i Komisionit disiplinor bazohet në thënie të rrejshme të dëshmitarit apo ekspertit;
 3. Nëse Vendimi i Komisionit disiplinor bazohet në dokumentacion të falsifikuar apo në të cilin është vërtetuar përmbajtje jo e vërtetë;
 4. Në qoftë se për të njëjtën kundërvajtje është marrë vendim i plotfuqishëm mbi përgjegjësinë e personit (ekipit-individit) respektivisht është ekzekutuar masa disiplinore
 5. Në qoftë se merret në dijeni për fakte të reja ose ofrohen mundësi të përdorimit të provave të reja në bazë të të cilave për kundërvajtësin do të mund të merrej vendim më i favorshëm sikur ato fakte apo prova do të ishin administruar në procedurën e mëparshme
 6. Në qoftë se me rastin e marrjes së vendimit ka marrë pjesë kryetari, ose anëtari i komisionit disiplinor i cili ka qenë i përjashtuar ose do duhej përjashtuar.

Neni 43

- 43.1 Propozimin për përsëritjen e procedurës disiplinore mund ta parashtrorjnë :
- Personi i dënuar,
 - Personat e dënuar apo ekipi,
 - Parashtruesi i Raportit apo Fletëparaqitjes,
 - Klubi apo Shoqata.
- 43.2 Propozimi i parashtrohet Komisionit disiplinor në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes në dijeni për ekzistimin e shkaqeve, e më së voni në afat prej 2 viteve nga dita e plotfuqishmërisë së Vendimit të nxjerr në procedurën disiplinore.

V. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 44

Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore, shfuqizohet Kodi Disiplinor i vitit 2022.

Neni 45

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi, shtatë (7) ditë pas nënshkrimit nga Kryetari i Federatës së Pingpongut të Kosovës dhe publikimit në faqen zyrtare të FPPK-së.

Nehat Çitaku



Kryetar